




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 09.01.2015

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 29.12.2014, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 772, të datës 12.12.2014, paraqitur nga Drejtoria për Financa dhe Buxhet, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në Nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (b dhe c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008) dhe Nenin 27, shkronja (c dhe ç), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M


1. Për rritjen e të hyrave vetjake për vitin fiskal 2014, në shumë totale prej 160,000.00€, të shpërndara nëpër kategoritë ekonomike buxhetore, kodet e programeve dhe kodet e projekteve si vijon:
 - 1.1 Mjetet financiare, në shumë prej 50,000.00€, lejohen për realizimin e projektit kapital 'Bashkëfinancimi i Projekteve 89168', në kodin ekonomik 30, programi 'Buxhet e Financa 17502';
 - 1.2 Mjetet financiare, në shumë prej 15,000.00€, lejohen për shpenzim në mallra dhe shërbime, programi 'Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale 73011', në kodin ekonomik 13, për furnizim me medikamente në shëndetësi dhe naftë për ngrohje qendrore;
 - 1.3 Mjetet financiare, në shumë prej 15,000.00€, lejohen për shpenzim në mallra e shërbime, programi 'Arsim dhe Shkencë 92010', kodi ekonomik 13, për pagesën e faturave për furnizim me ushqim dhe pije për Çerdhen e Fëmijëve 'Gëzimi Ynë';
 - 1.4 Mjetet financiare, në shumë prej 40,000.00€, lejohen për shpenzim në mallra e shërbime, programi 'Infrastrukturë Publike 18162', kodi ekonomik 13, për pagesën e faturave të furnizimit me naftë për ngrohje qendrore, për Administratën Publike dhe furnizim me material për zyre si dhe për qiranë e objektit të komunës;
 - 1.5 Mjetet financiare, në shumë prej 20,000.00€, lejohen për shpenzim në transfere, programi 'Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale 73011', kodi ekonomik 20, për ndihmë qytetarëve për terapi shëndetësore dhe Organizatën Joqeveritare "Nënë Tereza", për t'i ndihmuar në ushqim dhe veshëmbathje familjet skamnore;
 - 1.6 Mjetet financiare, në shumë prej 20,000.00€, lejohen për shpenzim në transfere, programi 'Arsim dhe Shkencë 92010', kodi ekonomik 20, për ndihmë studentëve e nxënësve me kushte të rënda ekonomike dhe nxënësve me nevoja të veçanta.

2. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë për Financa dhe Buxhet.
3. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e aprovimit, nga Kuvendi i Komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë për FB, Drejtorisë për Arsim, Drejtorisë për SHMS, Drejtorisë për SHPM dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Mr. Fadil Krasniqi





**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**



Datë: 12.01.2015

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 29.12.2014, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 778, të datës 17.12.2014, paraqitur nga Drejtoria për Shërbime Publike dhe Mjedis, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

1. Për aprovimin në parim të Planit Komunal për Eficiencë të Energjisë të komunës së Fushë-Kosovës, për periudhën 2014-2020 dhe procedimin e tij për diskutim publik.
2. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e aprovimit, nga Kuvendi i Komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë për SHPM dhe Arkivës.


**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Mr. Fadil Krasniqi**





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 12.01.2015

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 29.12.2014, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 160, të datës 17.12.2014, paraqitur nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, të shqyrtuar në Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 51, paragrafi 51.1, nenin 53 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 34, paragrafi 34.1, shkronja (b), paragrafi 34.4, nenin 36, nenin 38 të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

1. Për ndryshimin-plotësimin e Vendimit Nr. 28, të datës 06.03.2014, për përfaqësimin e komunitetit malazez, në përbërjen prej nëntë anëtarëve të Komitetit për Komunitete.
2. Për anëtare të Komitetit për Komunitete, nga komuniteti malazez, caktohet znj. Snezhana Karaxhiç.
3. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e aprovimit, nga Kuvendi i Komunës dhe shfuqizon Vendimin Nr. 28, të datës 06.03.2014.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë për FB, Drejtorisë për Administratë, Anëtares së Komitetit për Komunitete dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Mr. Fadil Krasniqi

